



KOMUNA E FUSHË KOSOVËS NË PARTNERITET ME PROGRAMIN ReLOaD2

SHPALL:

THIRRJEN E DYTË PUBLIKE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE PËR DORËZIMIN E PROJEKT PROPOZIMEVE NË PROGRAMIN RAJONAL PËR DEMOKRACINË LOKALE NË BALLKANIN PERËNDIMOR 2

(ReLOaD2)

Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2) është një iniciativë e financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën*. Ky program është vazhdim i nismës Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD, 2017-2020). Buxheti total i ReLOaD2 është 12.63 milionë euro (15.06 milionë dollarë), ndërsa komponenti për Kosovë është 1.38 milionë euro (1,64 milion dollarë). Kohëzgjatja e projektit është 48 muaj (Janar 2021 – Dhjetor 2024). Objektivi i përgjithshëm i ReLOaD2 është të forcojë demokracitë gjithëpërfshirëse në Ballkanin Perëndimor dhe procesin e integritetit në BE. Projekti do të punojë për fuqizimin e shoqërisë civile dhe rinisë që të jetë pjesë aktive në vendimmarrje, duke nxitur një mjedis ligjor dhe financiar në funksion të shoqërisë civile.

Objektivi specifik i Programit është të forcojë bashkëpunimin midis qeverisjes lokale dhe organizatave të shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor duke forcuar transparencën për financimin e Organizatave të Shoqërisë Civile nga buxheti i qeverisjes lokale. Gjithashtu programi ReLOaD2 synon të promovojë angazhimin qytetar me fokus të veçantë tek të rinjtë në mënyrë që të bëhen pjesë e proceseve vendimmarrës në funksion të zhvillimit të komunitetit.

Programi ReLOaD2 do të mbështesë shtatë komuna partnere (Dragash, Fushë Kosovë, Mitrovicë e Jugut, Podujevë, Rahovec, Skenderaj dhe Shtërpçë), me një qasje holistike duke filluar nga rritja e kapaciteteve të stafit të komunës për ciklin e menaxhimit të projekteve dhe metodologjisë LOD¹, grante, asistencë teknike gjatë shpalljes dhe zbatimit të thirrjeve publike, asistencë teknike gjatë zbatimit të thirrjeve publike të pavarura si edhe për fuqizimin e rinisë në territorin e saj.

Bazuar në këtë, Komuna e Fushë Kosovës dhe programi ReLOaD2 ftojnë të gjitha Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) në Kosovë që të dorëzojnë projekt propozime në fushat prioritare në vijim, megjithatë prioritetet do t'u jepet OSHC-ve që operojnë në Komunën e Fushë Kosovës.

OSHC-të me bazë në Komunën e Fushë Kosovës me përvojë pune në Komunën e Fushë Kosovës inkurajohen të aplikojnë.

* Për Bashkimin Evropian, ky emërtim është pa paragjykim për pozicionin mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 dhe Opininion e GjND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Për UNDP-në të gjitha referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

¹ https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/operations/projects/poverty_reduction/regional-programme-on-local-democracy-in-the-western-balkans--re.html

Prioritetet e përgjithshme (LOT 1)

1. Ndërgjegjësimi i qytetarëve për mbrojtjen e ambientit

- 1.1. Promovimi i aktiviteteve vetëdijësuese për mbrojtjen e ambientit
- 1.2. Rritja e njohurive për rëndësinë e mbrojtjes së ambientit nëpër shkolla
- 1.3. Përfshirja e qytetarëve në zhvillimin e aktiviteteve rekreative në natyrë dhe roli i saj për shëndetin e njeriut

2. Përkrahja e zhvillimit ekonomik përmes punësimit dhe vetëpunësimit të grave

- 2.1. Mbështetja për vetëdijësimin e grave për të drejtat e tyre në punësim
- 2.2. Promovimi i subjekteve për punësim dhe mekanizme të cilat ofrojnë mundësi punësimi
- 2.3. Mbështetja për praktikë të sapodiplomuarëve me pagesë

3. Promovimi i bashkëjetesës dhe përfshirja e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shoqëri

- 3.1. Nxitja e komuniteteve për të qenë pjesëmarrës në aktivitete të përbashkëta
- 3.2. Promovimi i të drejtave të komuniteteve në vendimmarrje dhe fuqizimi i tyre

Prioritetet e rinisë (LOT 2)

1. Mbështetja e zhvillimit profesional dhe rritjes së punësueshmërisë së të rinjve

- 1.1. Zhvillimi i programeve të trajnimit në teknologji informacioni dhe komunikimi,
- 1.2. Zhvillimi e trajnimeve për rritjen e aftësive të komunikimit, menaxhimit të puneve, shkrim të CV, si dhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një biznes, etj)
- 1.3. Organizimi i fushatave informuese dhe përgatitja e të rinjve për integrim në skemat e punësimit (trajnim në punë, praktikë në punë, programe shkëmbimi etj.)
- 1.4. Organizimi i eventeve të karrierës, si sesione informativ dhe prezantime nga kompanitë e ndryshme

2. Fuqizimi i rolit të grupeve rinore në komunitet

- 2.1. Organizimi i aktiviteteve të ndryshme për të rinj, si aktivitete sportive, kulturore, ekologjike, shkencore, letrare etj, që do t'u japin mundësinë të rinjve të kenë një impakt pozitiv në komunitetin e tyre.
- 2.2. Mbajtja e takimeve periodike për diskutimin e sfidave dhe mundësive të komunitetit dhe identifikimin e fushave ku të rinjve mund t'u kontribuojnë
- 2.3. Zhvillimi i kampeve edukative në natyrë

3. Promovimi i edukimit shëndetësor

- 3.1. Organizimi i fushatave informuese dhe seminareve për të promovuar rëndësinë e praktikave të shëndetshme, si sporti, ushqimi i shëndetshëm, shfrytëzimi i teknologjisë dhe si të integrojnë këto praktika në rutinën e tyre të përditshme
- 3.2. Organizimi i aktiviteteve sportive, si maratonat, ndeshjet e futbollit, turniret e volejbollit, etj
- 3.3. Organizimi i aktiviteteve të gatimit për të treguar njerëzve si të përgatisin ushqim të shëndetshëm dhe të kuptojnë rëndësinë e tij për një jetë të shëndetshme.

LOT 1: Shuma totale e dedikuar për këtë thirrje është rreth **38,500.00 EUR** (nga të cilat 30% financohet nga komuna e Fushë Kosovës),

LOT 2: Shuma totale e dedikuar për këtë thirrje është rreth **30,000.00 EUR**.

derisa vlera e granteve që do të ndahen në kuadër të kësaj thirrjeje publike duhet të jetë midis shumave minimale dhe maksimale në vijim:

- **LOT 1:** shuma minimale: 5,000.00 euro; shuma maksimale: 15,000.00 euro
- **LOT 2:** (shoqatat rinore) shuma minimale 5,000.00 shuma maksimale 10,000.00 EUR.

Aplikanti mund të dorëzojë maksimumi një projekt propozim për LOT, i cili përmban të gjitha dokumentet e kërkuara. I njëjti aplikant mund të aplikojë për maksimum 2 thirrje komunale në kuadër të ReLOaD2. Shuma maksimale e fondeve që mund t'i ndahen një OSHC-je aplikuese gjatë kohëzgjatjes së këtij projekti deri në dhjetor 2024 nuk mund t'i tejkalojë 30,000.00 euro.

Komuna rezervon të drejtën të mos i alokojë të gjitha fondet që ka në dispozicion në rast se projekt-propozimet e paraqitura nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara. Kohëzgjatja e secilit projekt duhet të zgjasë nga 6 deri në 9 muaj. Projektet e përzgjedhura do të zbatohen në periudhën nga muaji shtator 2023 deri në muajin qershor 2024.

PËRSHTATSHMËRIA/PRANUESHMËRIA:

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur, në baza të barabarta, për të gjitha OSHC-të e regjistruara zyrtarisht (shoqata/organizata apo fondacion) në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Kosovë. Të gjitha organizatat e shoqërisë civile të interesuara mund të gjejnë informacion të hollësishëm rreth kushteve për aplikim si dhe për kriteret për financimin e projekteve në Udhëzimin për Aplikantë, pjesë përbërëse e dokumentacionit të thirrjes publike.

DOKUMENTACIONI:

Të gjitha informatat dhe verzioni elektronik i të gjithë pakos së dokumenteve për aplikim mund të gjenden në adresat e mëposhtme: www.ks.undp.org, dhe në adresën zyrtare të komunës së Fushë Kosovës <https://kk.rks-gov.net/fushekosove/>

Dokumentet e aplikimit mund të merren:

1. Duke e dërguar një kërkesë për dokumentacionin për aplikim me emrin e OSHC-së së interesuar në këtë adresë të postës elektronike: fatlum.berisha@rks-gov.net ose personalisht, në adresën:

Komuna e Fushë Kosovës

Rr. Tahir Zemaj objekti i Komunës kati i dytë, departamenti i DKRS-së

2. Një verzion elektronik i dokumentacionit për aplikim po ashtu mund të shkarkohet nga:

Faqja e internetit e komunës (<https://kk.rks-gov.net/fushekosove/>)

Faqja e internetit e UNDP-së (www.ks.undp.org) dhe

<https://kosovofunding.org>

3. Ose duke ngarkuar personalisht USB-në me të gjitha formularët e aplikimit gjatë takimit informues "Ditët e hapura" të mbajtur me datë **13 qershor 2023**.

SESIONET INFORMUESE (Ditët e hapura për më shumë informacione)

Seancat informuese (ditët e hapura) do të mbahen në Komunën e Fushë Kosovës më datat **13 qershor 2023** në ora 10:00 paradite, duke pasuar të njëjtën ditë me trajnim mbi Ciklin e Menaxhimit të Projektit (CMP), dhe pastaj me **14, 15 dhe 16 qershor 2023** në Sallën e Asamblesë Komunale, gjithashtu duke filluar nga ora 10:00.

Qëllimi i trajnimit është të forcojë kapacitetet e organizatave për të hartuar dhe zbatuar projekte që kontribuojnë në zhvillimin lokal dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe të aplikojnë aftësitë e nevojshme për zhvillimin e ideve të projektit, shkrimin efektiv të projektit, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të

projektit përmes punës praktike. Në rast të interesimit të madh të OSHC-ve, seanca do të përsëritet. Rregullat dhe propozimet e thirrjes publike do të prezantohen në secilën seancë, së bashku me prezantimin e gabimeve të zakonshme që OSHC-të i bëjnë kur aplikojnë. Seancat informuese do të zhvillohen gjatë thirrjes publike.

Do të organizohet trajnimi mbi Ciklin e Menaxhimit të Projektit (CMP) për OSHC-të me fokus në përgatitjen e propozimeve (aplikimit për projekt, buxhetit, kornizën logjike dhe planin e veprimit).

Gjatë tërë kohëzgjatjes së **thirrjes publike do të ofrohet mbështetje nga ekspertët/mentorët**. Ndihami do të jetë e hapur dhe publike, ndërsa orari, duke përfshirë datën dhe orën, do të ndahet nëpërmjet faqes së internetit të komunës. Për qëllime të transparencës, procesverbali i takimeve me mentorin do të publikohet në ueb faqen e Komunës së Fushë Kosovës. Kjo do ta bëjë të disponueshme informacionin për OSHC-të që nuk kanë mundur të marrin pjesë në takimet me mentorin.

Përveç kësaj, të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me thirrjen publike mund të dorëzohen përmes postës elektronike në adresën e mëposhtme: registry.ks@undp.org duke iu referuar thirrjes publike. Pyetjet mund të dorëzohen deri më **18 korrik 2023**, ndërsa përgjigjet do të jepen me shkrim brenda tri (3) ditëve të punës pas datës së pranimit. Për qëllime të transparencës, të gjitha përgjigjet do të publikohen në faqen e internetit të UNDP-së (www.ks.undp.org).

Gjithashtu, dokumenti “Pyetjet më të shpeshta” do të publikohet në faqen e Komunës dhe UNDP-së gjatë thirrjes publike, së bashku me dokumentet e tjera të Thirrjes Publike. Dokumenti synon të ofrojë ndihmë shtesë për aplikantët në mënyrë që të kenë një pasqyrë të pyetjeve të bëra më parë që aplikantët kishin gjatë thirrjeve të mëparshme.

DORËZIMI I APLIKACIONEVE:

Seti i aplikimit përbëhet nga një kopje elektronike (USB) me dokumentacion të veçantë të detyrueshëm dhe shtesë dhe një kopje të dokumenteve që duhet të dorëzohen në formë të printuar. USB me të gjitha materialet e nevojshme për aplikim (përfshirë formularët e printuar), dorëzohet me një zarf të mbyllur me postë rekomandë ose personalisht në Komunën e Fushë Kosovës gjatë ditëve të punës (e hënë - e premte), në periudhën nga ora 09.00 deri në orën 15.00, me shënim për projektin ReLOaD2 në adresën:

Fushë Kosovë, 12000

Rr. Tahir Zëmaj, objekti i Komunës kati i dytë, departamenti i DKRS-së

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është **data 24 korrik 2023** në orën 15:00. Aplikacionet e pranuar pas afatit të fundit do të merren parasysh vetëm nëse vula postare tregon se ato janë dërguar para afatit të fundit zyrtar.

Aplikacionet e dërguara me anë të ndonjë mjeti tjetër (p.sh. postës elektronike) ose të dërguara në adresë të tjera **nuk do të merren në konsideratë**.

Ana e jashtme e zarfit duhet ta përmbajë emrin e thirrjes publike për projekt-propozime, emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit, emrin e plotë të projektit dhe fjalët: **“Mos e hap para hapjes zyrtare”**. Komuna do të mbajë evidencë për të gjitha projekt-propozimet e pranuar të OSHC-ve dhe do të lëshojë dëftesa përkatëse.

Para se ta dorëzojnë aplikacionin e plotë, OSHC-të aplikuese këshillohen që të vërtetojnë se dokumentacioni/aplikacioni i kërkuar është plotësuar. Kjo bëhet duke e plotësuar listën e kontrollit (Shtojca 10) e cila është pjesë përbërëse e aplikacionit.